



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
MINISTRI

Nr. 1213 prot.

Tiranë, më 04/05 /2020

URDHËR

Nr. 289, datë 04.05.2020

PËR MIRATIMIN E UDHËZUESIT PËR
“MASAT NDAJ COVID -19 QË DUHET TË NDËRMARRIN INSTITUCIONET
ARSIMORE”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 4, të ligjit nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimit nr. 496/12, datë 29.04.2020 të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni COVID-19,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Udhëzuesit për “Masat ndaj Covid -19 që duhet të ndërmarrin institucionet arsimore”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Ministria përgjegjëse për arsimin dhe institucionet e qeverisjes vendore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Ogerta Manastirliu



**UDHËZUES
PËR
“MASAT NDAJ COVID -19 QË DUHET TË NDËRMARRIN INSTITUCIONET
ARSIMORE”**

I. PËR NXËNËSIN/STUDENTËT

Hyrja dhe dalja nga ambientet e institucioneve arsimore

- Orari për hyrjen e nxënësve/studentëve në institucionet të arsimit rregullohet sipas një grafiku, hartuar nga drejtoria/administrata e institucionit arsimor dhe nën monitorimin e mësuesve/pedagogëve.
- Nxënësit/studentët paraqiten në institucionin arsimor duke respektuar me përpikëri orarin e komunikuar nga drejtoria/administrata e institucionit arsimor.
- Nxënësit/studentët hyjnë në institucionin arsimor pasi janë vendosur në radhë një nga një, me largësi 1.5 deri 2 metra.
- Nxënësi/studenti që ka simptoma të ngjashme apo temperaturë përpara ardhjes në institucionin arsimor, njofton mësuesin ose personin përgjegjës për çeshtjet shëndetësore paracaktuar nga drejtoria/administrata e institucionit arsimor, i cili, në bashkëpunim me mjekun e institucionit arsimor ose atë të familjes, verifikon nëse nxënësi/studenti është i sëmurë apo jo.
- Rekomandojmë që personi përgjegjës i institucionit arsimor, i caktuar nga drejtuesi/administrata e institucionit arsimor, duhet të kryejë procedurën për çdo nxënës/student si më poshtë vijon:
 - Matje të temperaturës me termometër digjital;
 - Sprucim me alkool 60% ose dezinfektantë të tjerë në duar;
 - Duhet të kontrollohen të gjithë nxënësit/studentët që të jenë të pajisur me maskë një përdorimshe ose mbrojtëse të fytyrës prej tekstili (maskë) të cilat duhet të lahen në 60 gradë dhe të hekurosen, si dhe shami letre për higjenën e hundëve;
- Sipas mundësive mund të vendosen vaska me solucion dezinfektues me bazë të klorit aktiv, për dezinfektimin e shuajve të këpucëve përpara hyrjes në ambientet e brendshme të shkollës/institucionit.
- Nuk lejohet që nxënësit/studentët të dalin nga godina dhe të rikthehen përsëri në të, brenda ditës.

- Lejohet vetëm një hyrje dhe një dalje në ndërtesën e institucionit arsimor.
- Dalja nga ambientet e tij do të bëhet sipas rregullave, duke ruajtur distancimin social dhe fizik si me lart (1.5 deri 2 metra), nën mbikëqyrjen e mësuesve kujdestarë/pedagogëve dhe të punonjësve të tjerë të institucionit.
- Nxënësit/studentët që nuk zbatojnë këtë rregullore, trajtohen me masë disiplinore nga Komisioni i Etikës dhe i Sjelljes.

Qëndrimi dhe mësimi në klasa/salla

- Gjatë procesit mësimor, mësuesi/pedagogu qëndron në klasë/sallë duke respektuar distancimin social dhe fizik me nxënësit/studentët dhe mësuesit/pedagogët e tjerë, në 1.5 deri 2 metra.
- Brenda klasës/sallës, nxënësit/studentët qëndrojnë të ulur në banka/tavolina të paktën 1.5 deri 2 metra larg njëri-tjetrit. Në klasat/sallat ku kjo nuk është e mundur, nxënësit/studentët do të ndahen në klasa/salla të tjera.
- Mësuesit/pedagogët sigurohen që në klasë/sallë të gjithë të jenë të pajisur me maskë dhe t'i mbajnë rregullisht ato.
- Kur është e mundur, praktikohet mësimi në ambient të hapur (oborri i institucionit), duke respektuar largësinë dhe rregullat e mësipërme.
- Nuk lejohet ushqimi në klasë/sallë.

Lëvizjet në mjediset e brendshme të institucionit arsimor

- Lëvizja e nxënësve/studentëve në klasa/salla, laboratorë, palestra dhe nëpër korridore duhet të jetë e përcaktuar në mënyrë që çdo zonë të ketë numrin më të vogël të individëve që lëvizin në të. Kjo do të thotë, p.sh., nxënësit/studentët e klasës I^a/kursi, do të hyjnë vetëm në sallën e përcaktuar për nxënësit/studentët e kësaj klase/kursi, do të përdorin vetëm tualetin në korridorin ku ndodhet klasa/salla e tyre, pa u takuar asnjë moment me nxënës/studentë të klasave të tjera.
- Rregullat për lëvizjen e nxënësve/studentëve duhet të jenë të afishuara në ambientet e klasave dhe në korridore.
- Nuk lejohen qëndrimet në korridore.
- Nxënësit/studentët të mbajnë largësinë minimale 1.5 deri 2 metra nga njëri-tjetri kur lëvizin në korridore.
- Komunikimi, në rast nevojë, i nxënësit/studentit me drejtuesit, sekretarinë dhe stafin mësimor, do të kryhet nëpërmjet mësuesit/pedagogut përgjegjës, duke respektuar distancimin social e fizik dhe rregullat e tjera të përcaktuara me lart. Mund të jetë edhe nëpërmjet telefonit apo kompjuterik, kur nxënësi/studenti nuk ndodhet në klasë/sallë.

- Nuk do të përdoren materiale të printuara, përveç rasteve kur nxënësit/studentët kanë libra të cilat i mbajnë tek sendet personale, ose në shtëpi.
- Nuk do të përdoren sende personale të panevojshme për procesin mësimor.
- Nuk do të kontaktohen personat që mund të jenë të pranishëm në mjediset e institucionit arsimor.

Kujdesi për higjienën

- Nxënësit/studentë të ndërgjegjësohen dhe të mbahen në komunikim të vazhdueshëm për rëndësinë që ka distancimi fizik dhe higjiena personale në ambientet brenda dhe jashtë institucionit arsimor, nëpërmjet mesazheve sensibilizuese të shpërndara nga ekipi mjekësor dhe shërbimi psiko-social i shkollës.
- Nxënësve/studentëve duhet t'u flitet në mënyrë të vazhdueshme për rregullat e higjienës, larjen e duarve, mënyrën e kollitjes dhe teshtitjes.
- Çdo nxënës/student në institucionin arsimor duhet të lajë duart pas çdo veprimi që mund të përbëjë rrezik për përhapjen e virusit: prekja e hundës, syve, gojës, etj.
- Duhet të sigurohen: uji i rrjedhshëm, sapuni i lëngshëm, letra për fshirjen e duarve dhe xheli me përmbajtje alkooli 60%, në ambientet e institucionit arsimor.
- Gjatë qëndrimit në ambientet e institucionit arsimor, çdo individ duhet të mbajë detyrimisht maskë.
- Dritaret duhet të mbahen të hapura, ose të paktën ose të paktën klasat/sallat, laboratorët, të ajrosen 5-6 herë gjatë kohës së mësimin.
- Klasat/sallat duhet të kenë aq nxënës/studentë sa lejojnë distancimin 1.5 deri 2 metra nga njëri nxënës/student tek tjetri. Janë të ndaluara takimet dhe mbledhjet ballë për ballë në ambientet e institucionit arsimor.
- Nëse nxënësi/studenti manifeston gjendje stresi dhe ankthi, ai i drejtohet shërbimit psiko-social të institucionit arsimor.
- Në një klasë/sallë apo laborator të mos qëndrojnë më shumë nxënës/studentë sesa mund të qëndrojnë në atë mjedis, duke respektuar distancimin social dhe fizik.
- Aktivitetet jashtëshkollore, sportive e artistike në grup janë të ndaluara.
- Të jenë të afishuara në të gjitha ambientet e institucionit arsimor, postera mbi masat e parandalimit të infeksionit COVID-19 dhe postera me mesazhe të qarta dhe të thjeshta.
- Të vendosen postera të veçantë për mënyrën e larjes së duarve.
- Në hyrje dhe në dalje të ambienteve të institucionit arsimor, rekomandohet të vendoset një higjenizues për duart në trajtë solucioni me përmbajtje aktive të alkoolit 60%, i cili duhet të jetë gjatë gjithë kohës i pranishëm
- Të kryhet dezinfektimi i çdo klase/salle, çdo ditë. Pas përfundimit të procesit mësimor, të kryhet pastrimi i sipërfaqeve dhe orendive me lëndë dezinfektuese.

- Në fund të çdo dite duhet të planifikohet dhe kryhet edhe denzifektim i mjediseve të përbashkëta të institucionit arsimor.
- Do të pranohen në ambientet e institucionit arsimor vetëm nxënësit/studentët apo prindërit (në rastet e nxënësve të ciklit fillor) që do të firmosin rregulloren mbi parandalimin e përhapjes së COVID-19.
- Përpara se të rifillojnë mësimin në ambientet e institucionit arsimor, sipas rregulloreve të reja për parandalimin e përhapjes së COVID-19, nxënësit/studentët duhet të plotësojnë Formularin e Vetëdeklarimit për situatën e tyre shëndetësore dhe të familjarëve të tyre, e cila shërben për të hetuar paraprakisht mundësinë e një vatre infeksioni COVID-19.
- Nxënësit/studentët që nuk zbatojnë rregulloren, trajtohen me masë sipas rregulloreve të institucionit arsimor.

II. PËR MËSUESIN/PEDAGOGUN

- Staf i mjekësor i institucionit arsimor, ose personeli i institucionit i caktuar nga drejtuesi dhe i trajnuar për veprimet e mëposhtme, kryen për çdo nxënës/student procedurën si më poshtë:
 - Mat temperaturën me termometër digjital.
 - Spërkat solucion dezinfektues me përmbajtje 60% alkooli në duart e nxënësve/studentëve dhe të stafit.
 - Kontrollon nëse çdo nxënës/student është i pajisur me maskë.
- Gjatë orës së mësimin, mësuesi/pedagogu qëndron në klasë/sallë duke respektuar distancimin social dhe fizik me nxënësit.

III. PËR PERSONELIN NDIHMËS

Sanitaret

- Sanitaret të mbajnë gjatë gjithë orarit të punës maskën, dorezat dhe solucione dezinfektuese.
- Korridoret pastrohen çdo dy orë.
- Tualetet pastrohen e dezinfektohen çdo 30 minuta.
- Rezervuarëve të ujit që mund të ketë institucioni arsimor, u hidhet klor sipas udhëzimeve përkatëse çdo ditë.
- Dorezat e çdo klase/salle dhe mjedisi pune si dhe parruket e shkallëve dhe vende të tjera pastrohen dhe dezinfektohen çdo 30 minuta.
- Largimi nga institucioni arsimor bëhet pas përfundimit të pastrimit dhe dezinfektimit të çdo mjedisi të tij.

- Kryen të gjitha detyrat duke respektuar distancimin social dhe fizik me nxënësit/studentët dhe mesuesit/pedagogët.

Roja i institucionit/oficeri i sigurisë

- Roja/oficeri i sigurisë të mbajë gjatë gjithë orarit të punës maskën, dorezat dhe solucione dezinfektuese.
- Roja nuk lejon prezencën e prindërve dhe çdo individ tjetër brenda në institucion (me përjashtim të nxënësve/studentëve dhe personelit të deklaruar të institucionit arsimor).
- Çdo kërkesë për komunikim me drejtuesin/administratën e institucionit të bëhet nëpërmjet numrit të kontaktit të përcaktuar paraprakisht.
- Kryen të gjitha detyrat duke respektuar distancimin social dhe fizik me nxënësit/studentët dhe mesuesit/pedagogët dhe sanitaret.

IV. PËR PRINDIN

- Nënshkruan ose konfirmon në rrugë elektronike, tek mësuesi/pedagogu, apo mësuesi kujdestar /pedagogu, këtë rregullore.
- Plotëson formularin e vetëdeklarimit ditor me përgjegjësi për gjendjen shëndetësore të fëmijës në numrin e kontaktit të mësuesit kujdestar.
- Në rast nevojë për komunikim me mësuesin/pedagogun, apo drejtuesin, përdor vetëm komunikimin elektronik.
- Në rastet e shoqërimit të fëmijës/fëmijëve në institucionin arsimor, nuk futet brenda mjedisit të shkollës për çfarëdo arsyeje që mund të paraqesë.

V. PËR DREJTUESIT

- Ngrenë grupe pune dhe hartojnë planet e veprimit për menaxhimin e situatës, garantimin e standardeve dhe respektimin e rregullave të përcaktuara më këtë rregullore.
- Monitorojnë pajisjen e nxënësve/studentëve dhe të stafit me mjetet mbrojtëse, si: maskë, doreza, xhel dezinfektues për përdorim personal (sipas mundësive).
- Mbajnë kontakte, përmes komunikimit elektronik, me njësinë e vetëqeverisjes vendore, njësinë e mbrojtjes së fëmijëve, strukturat e Shëndetit Publik, Policinë e Shtetit dhe organet e tjera ligjzbatuese për ecurinë e procesit mësimor.
- Për çdo nxënës/student i cili paraqet probleme shëndetësore, si p.sh rritje të temperaturës etj., apo ka njoftim nga prindi, ka patur kontakt me dikë të prekur me COVID-19, si dhe nëse prindi përkatës është i sëmurë, apo ka patur kontakte me COVID-19, lajmëron menjëherë Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) dhe strukturën përkatëse në këto njësi.

- Për çdo mësues/pedagog apo personel tjetër të institucionit arsimor, i cili paraqet probleme shëndetësore, si p.sh. rritje të temperaturës, etj., apo ka njoftim se ka patur kontakt me dikë të prekur me COVID-19, lajmëron menjëherë Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) dhe strukturën përkatëse në këto njësi.

DREJTOR

Albana FICO